



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 29 nëntor 2018
Nr. ref.: 1893/18/rl

Znj. Rina Kika, avokate
Rr. "Edith Durham", B1, nr. 1/11
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Lënda: Njoftim dhe kërkesë për informata shtesë, lidhur me kërkesën KI108/18

E nderuara avokate, znj. Kika,

Siç edhe jeni njoftuar, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) kërkesën tuaj të 30 korrikut 2018 e ka pranuar dhe e ka regjistruar në regjistrin e saj përkatës me nr. KI108/18.

Lidhur me shkresën tuaj të 20 nëntorit 2018, në të cilën pohoni të keni dorëzuar një kërkesë për informata në adresën elektronike të Gjykatës më 20 tetor 2018, ju informojnë se Gjykata, në adresën e saj elektronike (gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org), nuk ka pranuar asnjë e-mail në atë datë apo në ndonjë datë tjetër nga ana juaj.

Sa i përket statusit të procedurës në rastin KI108/18, Gjykata ju njofton se lënda është në proces të shqyrtimit. Deri më tani, *inter alia*, janë ndërmarrë hapat proceduralë si në vijim: është caktuar Gjyqtari raportues për lëndën si edhe Kolegji shqyrtues. Janë njoftuar të gjitha palët e interesuara në procedurë si dhe është kërkuar nga ato që të paraqesin komente e tyre. Kërkesa e Avokatit të Popullit, që të paraqitet si Amicus Curiae para Gjykatës, është shqyrtuar dhe është miratuar në bazë të paragrafit (1) të rregullit 55 [Amicus Curiae] të Rregullores së punës, pa paragjykuar në asnjë mënyrë pranueshmërinë apo meritat përfundimtare të rastit, e të cilat do të vendosen nga Gjykata në bazë të rregullave dhe procedurave të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

Ju njoftojmë po ashtu që Gjykata e ka njoftuar edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës për regjistrimin e kërkesës dhe i ka dhënë mundësinë që të paraqesë komente lidhur me pretendimet e paraqitura në kërkesë, duke u përgjigjur në disa pyetje të Gjykatës. Kjo e fundit, pas kërkesës së përsëritur për paraqitje të komenteve lidhur me pyetjet e Gjykatës, ka pranuar disa komente nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Në këtë drejtim, Gjykata ju fton të gjeni të bashkëngjitura shkresat e Gjykatës drejtuar

Këshillit Gjyqësor të Kosovës si dhe një kopje të komenteve të tyre të dorëzuara në Gjykatë.

Lidhur me komentet e pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në rast se keni ndonjë koment shtesë mbi komentet e pranuar nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, luteni që t'i dorëzoni në Gjykatë jo më vonë se më 10 dhjetor 2018.

Po ashtu, brenda afatit të sipërpërmendur, luteni që të informoni Gjykatën lidhur me dy çështjet në vijim:

- (1) A keni paraqitur ndonjë kërkesë për përshpejtim të procedurës apo ndonjë kërkesë ekuivalente në Gjykatën Themelore në Prishtinë? Nëse po, luteni që të dorëzoni një kopje të dokumentit përkatës dhe çdo dokument tjetër, informatë shtesë apo përgjigje që mendoni se është relevante në këtë drejtim.
- (2) A ka ndërmarrë Gjykata Themelore në Prishtinë ndonjë hap, deri më tani?

Ju falënderojmë!

Bashkëngjitur: Shkresa, nr. ref.: 1572/18/rl, e 16 tetorit 2018;
Shkresa, nr. ref.: 1759/18/rl, e 8 nëntorit 2018; dhe
Komentet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 20 nëntorit 2018.

Me respekt,

Milot Vokshi
Sekretari Përgjithshëm





REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 16 tetor 2018
Nr. ref.:1572/18/rl

Z. Nehat Idrizi, Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Lënda: Njoftim për regjistrimin e kërkesës KI108/18 dhe kërkesë për komente

I nderuari z. Idrizi,

Po ju drejtohem për t'ju informuar dhe kërkuar komentet tuaja rreth rastit të regjistruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) me nr. KI 108/18, me parashtrues Blerta Morina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi). Në kërkesë kontestohet kushtetutshmëria e Vendimit [Nr. 64/04] të 13 qershorit 2018 të Agjencisë së Regjistrimit Civil. Të njëjtin Vendim, parashtruesi e konteston edhe në Departmentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Në Gjykatë, parashtruesi pretendon se Vendimi i lartcekur ia shkelë të drejtat e garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, më konkretisht lidhur me aspektin procedural të shterimit të mjeteve juridike, parashtruesi pretendon se inicimi i padisë për konfliktin administrativ kundër Vendimit të kontestuar të Agjencisë së Regjistrimit Civil pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë "*nuk përbën një mjet efektiv juridik*" në përputhje me garancitë e Kushtetutës, KEDNJ-së si dhe në bazë të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), të cituar specifikisht në kërkesën KI108/18. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës pretendon se ekzistojnë "*rrethana të veçanta*" në bazë të të cilave duhet të lirohet nga detyrimi për të shteruar të gjitha mjetet juridike.

Në të njëjtën linjë të argumentimit qëndron edhe Avokati i Popullit, i cili më 26 shtator 2018, bazuar në rregullin 55 [Amicus Curiae] të Rregullores së punës së Gjykatës, në Gjykatë ka dorëzuar kërkesën për tu paraqitur si *Amicus Curiae* lidhur me rastin KI108/18. Gjykata ka shqyrtuar dhe miratuar sipas procedurës së paraparë me rregullin e lartcekur të Rregullores së punës kërkesën e Avokatit të Popullit.

Lidhur me argumentimin e parashtruesit mbi shterimin e mjeteve juridike dhe çështjen e efektivitetit të tyre si dhe argumentimin e Avokatit të Popullit në këtë aspekt, Gjykata ju fton që të gjeni të bashkëngjitur një kopje të kërkesës KI108/18 dhe një kopje të Mendimit Juridik të Avokatit të Popullit.

Në këtë drejtim, Gjykata kërkon komentet tuaja rreth pretendimeve të parashtruesit dhe Avokatit të Popullit, që në rrethanat e rastit konkret, padia për inicimin e konfliktit administrativ nuk paraqet mjet efektiv juridik.

Komentet tuaja në çështjet specifike të shtruara në vijim, dhe të ndërtuara mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, do t'i shërbenin Gjykatës, që të bëjë vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe Avokatit të Popullit rreth shterimit të mjeteve juridike në rrethanat e rastit konkret:

1. A konsideroni se padia për inicim të konfliktit administrativ si mjet juridik, i përmbush standardet e të qenurit "mjaftueshëm i sigurtë, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë", në rrethanat e rastit konkret.
2. A konsideroni se padia për inicim të konfliktit administrativ si mjet juridik, i plotëson standardet e duhura për t'u konsideruar si i "disponueshëm" për parashtruesin, i "qasshëm" për të dhe "efektiv" në lidhje me pretendimet e ngritura në kërkesën KI108/18. Shembuj nga praktika gjyqësore në këtë drejtim do të ishin të dobishëm.
3. A konsideroni se padia për inicim të konfliktit administrativ si mjet juridik, ofron "mundësinë e korrigjimit" përkatës dhe "mundësinë e arsyeshme për sukses" në lidhje me pretendimet e parashtruesin të ngritura në kërkesën KI108/18. Shembuj nga praktika gjyqësore në këtë drejtim do të ishin të dobishëm.
4. A konsideroni se ekzistojnë "rrethana të veçanta" në rastin e parashtruesit së kërkesës e që potencialisht do përmbushnin kriteret për lirimim e parashtruesit nga detyrimi për shterjen e mjeteve juridike.

Luteni që komentet/përgjigjet tuaja dhe/ose të organeve kompetente të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, t'i dorëzoni në Gjykatë jo më vonë se më 31 tetor 2018.

Me respekt,

Milot Vokshi
Sekretar i Përgjithshëm





REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 8 nëntor 2018
Nr. ref.:1759/18/rl

Z. Nehat Idrizi, Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Lënda: Kërkesë e përsëritur për komente në rastin KI108/18

I nderuari z. Idrizi,

Siç edhe jeni në dijeni, më 16 tetor 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), ju ka njoftuar për regjistrimin e kërkesës KI108/18, si dhe ju ka dorëzuar një kopje të Mendimit Juridik të dorëzuar nga Avokati i Popullit lidhur me kërkesën KI108/18.

Gjykata, nëpërmjet letrës së saj [Nr. ref.: 1572/18/rl], ju ka dhënë mundësinë që të paraqitni komentet tuaja dhe/ose të organeve kompetente të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me pretendimet e paraqitura në kërkesën KI108/18 dhe në Mendimin Juridik të Avokatit të Popullit, për sa i takon aspektit procedural të shterimit të mjeteve juridike. Në atë aspekt, Gjykata ju ka lutur që të dorëzoni komentet/përgjigjet tuaja, duke u fokusuar në katër çështjet specifike të paraqitura në letrën e Gjykatës, jo më vonë se më 31 tetor 2018.

Ne vërejmë që, brenda afatit të përcaktuar, ju nuk keni dorëzuar ndonjë koment/përgjigje. Andaj, me këtë rast, Gjykata ju jep një afat shtesë prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të kësaj shkrese, që të dorëzoni komentet/përgjigjet tuaja lidhur me kërkesën KI108/18, ashtu siç është kërkuar me letrën paraprake të Gjykatës, të cilën po e bashkëngjisim dhe njëherë për konsideratën tuaj.

Ju faleminderit!

Me respekt,

Milot Vokshi
Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO Kain Kushtetuese / Ustavni Sud / Constitutional Court		
Nr. i faqesve Br. stranica No. pages	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Data Datum Date
2	1856	20.11.2018



Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr. Br. No.	01 / 528
DAT. DT.	20.11.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Pranuar / Primijeno	
20 NOV 2018	
Në ora	časova

PËR: Gjyqtaret e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

PËRMES:

PREJ: Nehat Idrizi, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

KOPJE: Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshëm- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

LËNDA: Përgjigje e Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me kërkesën e parashtruar për dhënie të komenteve për rastin KI108/18

DATA: 19 nëntor 2018

NR. REF.:

Të nderuar gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KGJK) me datë 8 nëntor 2018, përmes Sekretarisë së Gjykatës Kushtetuese, ka pranuar kërkesën e parashtruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese për dhënie të komenteve në lidhje me rastin KI108/18.

KGJK, në mbështetje të nenit 22 par.2 të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), paraqet përgjigjen si në vijim:

1. Në lidhje me pyetjen tuaj të parë mendojmë se padia si mjet i rregullt juridik për iniciimin e konfliktit administrativ i përmbush të gjitha standardet për të qenë mjaftueshëm i sigurt për rastin konkret dhe rastet e tjera marrë parasysh atë se gjykatat janë të pavarura, apolitike, të paanshme dhe sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë. Për më tepër paragrafi 5 i nenit 55 të Kushtetutës së republikës së Kosovës e përcakton, e citoj: "Me rastin e kufizimit të të drejtave të



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.”.

2. Në lidhje me kërkesën tuaj të dytë konsiderojmë se padia për inicimin e konfliktit administrativ si mjet juridik i plotëson standardet e duhura për të tu konsideruar si mjet i disponoheshim për parashtruesin , pasi që gjykatat mundësojnë dhe sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë dhe gjithnjë bëjnë përpjekje të jenë sa me efektive dhe efikase në zgjidhjen e rasteve përkundër asaj që ballafaqohen me një numër të madh të rasteve të pazgjidhura të cilat janë grumbulluar nga një serë faktorësh siç rastet e mbetura nga vitet paraprake, rastet e reja të pranuar ne punë, numëri i pamjaftueshëm i gjyqtareve etj.
3. Në lidhje me kërkesën tuaj të tretë konsiderojmë se vetëm vendimi i gjykatës mund të vërtetoj këtë, pasi që KGJK është organ i mandatuar që të bëj vetëm administrimin e gjyqësorit, por që nuk ka kompetencë të ndërhyjë në punët e gjyqtareve , të cilët në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, janë të pavarur në rastin e vendosjes në çështje që zhvillohet pran gjykatave.
4. Sa i parkete kërkesës suaj të katërt, konsiderojmë se është në mandatin e Gjykatës Kushtetuese që të vendos se “a ekzistojnë rrethana” të veçanta ne rastin e parashtruesit të kërkesës KI108/18 që potencialisht do të përmbushnin kriterin për lirimin e parashtruesit nga detyrimi për shterjen e mjeteve juridike.

Me respekt,